


01-1809



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-236742/22 dt.28.10.2022, të kërkuësve / pronarëve, Muharrem dhe Ismet Bullatovci, nga Prishtina, dhe investitorit “Alko Group” sha, me seli në Prishtinë në rr. “Bedri Berisha”, ndërtesa “B”, lokali nr. 1 dhe “Noki-O-S-2008” nga Tirana/Dega Prishtinë, në rr. “Ndue Perlleshi”, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “D1” dhe Ndërtesa “D2”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Mati I”, në rr. “Ukshin Kovaçica”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregulltë administrative, me datë 15.05.2023, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuësve / pronarëve, Muharrem dhe Ismet Bullatovci, nga Prishtina dhe investitorit “Alko Group” sha, me seli në Prishtinë në rr. “Bedri Berisha”, ndërtesa “B”, lokali nr. 1 dhe “Noki-O-S-2008” nga Tirana/Dega Prishtinë, në rr. “Ndue Perlleshi”, sipas kërkesës 05Nr.391/02-236742/22 dt.28.10.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm Ndërtesa “D1”, me etazhitet 2B+P+8+Nk dhe Ndërtesa “D2”, me etazhitet B+P+6+Nk e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351-247529/1 dt.230.12.2015, në parcelën kadastrale nr. 1518-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-01518-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Matiçan”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Ukshin Kovaçica” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 82, 84, 86, 88 dhe 90, për Ndërtesën “D1” dhe numrat 72, 74, 76, 78 dhe 80, për Ndërtesën “D2” në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuësve / pronarëve, Muharrem dhe Ismet Bullatovci, nga Prishtina dhe investitorit “Alko Group” sha, me seli në Prishtinë në rr. “Bedri Berisha”, ndërtesa “B”, lokali nr. 1 dhe “Noki-O-S-2008” nga Tirana/Dega Prishtinë, në rr. “Ndue Perlleshi”, me kërkesën me 05Nr.391/02-236742/22 dt.28.10.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “D1”, me etazhitet 2B+P+8+Nk dhe Ndërtesa “D2”, me etazhitet B+P+6+Nk të ndërtuara e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Mati I”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1518-0 ZK Matiçan, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore

05Nr.351-247529/1 dt.230.12.2015, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-113258/22 dt. 08.06.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Fitnete Gorçaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Bujar Emra; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Zarife Sallahu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Ismet Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Vedat Sjenicaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bajselmani me nr. të licensës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuessit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-236742/22 DT. 15.05.2023**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B. Vllasaliu*

Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi  
*Nazife Krasniqi*

Drejtori,  
Arber Sadiki  
*Arber Sadiki*

Faqe 2 prej 2

